



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES

Nr.165/4 prot.

Tiranë, më 20.02.2026

V E N D I M

Nr. 16, datë 20.02.2026

MBI PËRFUNDIMIN E VERIFIKIMIT TË LIGJSHMËRISË SË VEPRIMEVE ADMINISTRATIVE TË KRYERA GJATË ZHVILLIMIT TË PROCEDURËS SË KONKURRIMIT ME KOD #7260, PËR GRUPIN E POZICIONEVE, “SPECIALIST NË SEKTORIN E AUDITIMIT TË BRENDSHËM PËR SKEMAT KOMBËTARE, NË DREJTORINË E AUDITIMIT TË BRENDSHËM, NË AGJENCINË PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL, KLASA E PAGËS IV-2”, TË SHPALLUR NGA DAP

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të veprimeve administrative të kryera gjatë zhvillimit të procedurës së konkurrimit me kod #7260, për grupin e pozicioneve, “Specialist në Sektorin e Auditimit të Brendshëm për Skemat Kombëtare, në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm”, në institucionin Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural,

VËREJ SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me shkresën nr. 165 prot., datë 23.01.2026 ka administruar informacionin e dërguar nga kandidati Majlind Shkira, pjesëmarrës në procedurën e konkurrimit me kod #7260, “Shpallje për lëvizje paralele, pranim në shërbimin civil, në kategorinë ekzekutive”, lloji i diplomës “Shkenca Ekonomike/Shkenca Juridike”, niveli minimal i diplomës “Master Profesional”, për plotësimin e dy

pozicioneve “*Specialist në Sektorin e Auditimit të Brendshëm për Skemat Kombëtare, në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm, në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, klasa e pagës IV-2*”, të shpallur nga DAP, në përmbajtje të së cilit ngrihen pretendime për vlerësim të padrejtë të kandidatit në fjalë, gjatë procesit të konkurrimit në fazën e pranimi në shërbimin civil, nga ana e Komitetit të Përhershëm të Pranimi (KPP).

Nga përmbajtja e informacionit të administruar pranë Komisionerit me shkresën nr. 165 prot., datë 23.01.2026, rezulton se kandidati Majlind Shkira ka aplikuar për të marrë pjesë në fazën e pranimi në shërbimin civil, për procedurën e konkurrimit me kod #7260, “*Shpallje për lëvizje paralele, pranim në shërbimin civil, në kategorinë ekzekutive*”, lloji i diplomës “*Shkenca Ekonomike/Shkenca Juridike*”, niveli minimal i diplomës “*Master Profesional*”, për grupin e pozicioneve “*Specialist në Sektorin e Auditimit të Brendshëm për Skemat Kombëtare, në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm, në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, klasa e pagës IV-2*”, të shpallur nga DAP.

Pas njoftimit mbi rezultatet individuale të vlerësimit, kandidati, duke mos qenë dakord me rezultatin e marrë, ka paraqitur ankesë pranë DAP-it, me anë të cilës ka kërkuar rivlerësimin e intervistës së strukturuar me gojë dhe të jetëshkrimit.

Në informacionin e përcjellë pranë Komisionerit parashtrohet se, procedura e ndjekur nga Komiteti i Përhershëm i Pranimi (KPP) gjatë vlerësimit të intervistës së strukturuar me gojë dhe të jetëshkrimit të kandidatit Majlind Shkira, ka qenë në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil. Gjithashtu, pretendohet se nuk i është vënë në dispozicion kopje e regjistrimit të intervistës së strukturuar me gojë, si dhe aktet përkatëse të hartuara nga KPP-ja.

Në këto kushte, kandidati ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim konstatimin e shkeljeve ligjore të pretenduara dhe rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë.

Me qëllim verifikimin e informacionit, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11 dhe nenit 14, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ka nisur procesin e verifikimit të informacionit dhe nëpërmjet shkresës nr.165/1 prot., datë 02.02.2026, me objekt: “*Kërkesë për dokumentacion në lidhje me verifikimin e informacionit të ardhur me shkresën nr. 165 prot., datë 23.1.2026, pranë Komisionerit, të dërguar nga kandidati Majlind Shkira*”, ka vënë në dijeni institucionin e Departamentit të Administratës Publike për fillimin e verifikimit të procedurës së konkurrimit, si dhe ka kërkuar dokumentacionin përkatës.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, Departamenti i Administratës Publike, nëpërmjet shkresës nr.6086/3 prot., datë 05.02.2026, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 165/2 prot., datë 09.02.2026, ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar, nga përmbajtja e së cilit rezulton se:

- Në zbatim të nenit 22, të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe të pikave 1 dhe 3, të kreut III, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*, të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, me Urdhrin nr. 675, (nr.5866/4 prot.), datë 04.12.2025, të Departamentit të Administratës Publike, është ngritur Komiteti i Përhershëm i Pranimi.
- Në zbatim të nenit 22 deri 25, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe të kreut II, IV dhe VII, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, DAP ka shpallur procedurën e konkurrimit me kod #7260, *“Shpallje për lëvizje paralele, pranim në shërbimin civil, në kategorinë ekzekutive”*, lloji i diplomës *“Shkenca Ekonomike/Shkenca Juridike”*, niveli minimal i diplomës *“Master Profesional”*, për grupin e pozicioneve *“Specialist në Sektorin e Auditimit të Brendshëm për Skemat Kombëtare, në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm, në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, klasa e pagës IV-2”*, ku rezulton se, kandidati Majlind Shkira ka qenë pjesëmarrës në fazën e pranimi në shërbimin civil.
- Sipas dokumentacionit të administruar në dosjen e konkurrimit, kandidati M. Shkira ka marrë pjesë në testimin me shkrim, (*procesverbal i datës 05.12.2025*) dhe në intervistën e strukturuar me gojë, (*procesverbal i datës 12.12.2025*), ku ka nënshkruar deklaratën e pranimi të regjistrimit me zë të intervistës me gojë.
- Anëtarët e KPP-së, kanë nënshkruar deklaratën e paanësisë, duke shprehur se nuk kanë konflikt interesi me kandidatin pjesëmarrës në konkurrim.
- Anëtarët e KPP-së, kanë hartuar listën e pyetjeve të intervistës së strukturuar me gojë.
- KPP-ja, ka hartuar raportin në datën 17.12.2025, *“Për rezultatin e procedurës së pranimi në kategorinë ekzekutive në shërbimin civil”*, nga rezulton se procedura e konkurrimit është mbyllur pa kandidatë fitues.
- Kandidati Majlind Shkira është vlerësuar me 38 pikë për testimin me shkrim, 10 pikë për dokumentacionin e dorëzuar dhe 5,6 pikë për intervistën e strukturuar me gojë, në total vlerësuar me 53.6 pikë.

Pas njoftimit mbi rezultatet individuale të vlerësimit, kandidati, duke mos qenë dakord me rezultatin e marrë, ka paraqitur ankesë pranë DAP-it, me anë të cilës ka kërkuar rivlerësimin e intervistës së strukturuar me gojë dhe të jetëshkrimit.

Pas administrimit të ankesës, si dhe në kushtet kur kandidati Majlind Shkira ka pranuar që intervista të regjistrohet, Departamenti i Administratës Publike në rolin e njësisë përgjegjëse, ka caktuar një takim midis kandidatit dhe anëtarëve të KPP-së, ç’ka provohet

me procesverbalin e datës 29.12.2025, nga ku rezulton se, kandidati ka ridëgjuar regjistrimin e intervistës së strukturuar me gojë, në prani të anëtarëve të KPP-së, si dhe është sqaruar nga KPP-ja në lidhje me vlerësimin me pikë për çdo pyetje.

Gjithashtu, nisur nga përmbajtja e deklaratës së datës 12.12.2025, *“Mbi regjistrimin me zë të intervistës me gojë për procedurën e pranimit në shërbimin civil”*, të nënshkruar nga kandidati, rezulton se: *“... Me nënshkrimin e kësaj deklarate pranoj që mund të aksesoj regjistrimin dhe përmbajtjen e tij vetëm nëpërmjet ridëgjimit, në ballafaqim me anëtarët e Komitetit. Regjistrimi me zë dhe përmbajtja e tij nuk mund të publikohen, si dhe nuk mund të përcillen te persona të tretë”*, ç’ka vërteton se, ky proces është pjesë e procedurës dhe kandidati ka qenë në dijeni dhe e ka pranuar këtë fakt.

Më tej, duke qenë se kandidati ka ngritur sërish disa pretendime, Komiteti i Përhershëm i Pranimit, si një organ kolegjal (referuar udhëzimit nr. 2, datë 27.3.2015, të DAP), është mbledhur për të marrë në shqyrtim ankesën e kandidatit, fakt i dokumentuar në procesverbalin e datës 30.12.2025, i cili i është përcjellë atij me shkresën nr. 6086/1 prot., datë 05.01.2026, nga përmbajtja e së cilës, rezulton se vlerësimi përfundimtar për kandidatin M. Shkira, ka mbetur i njëjtë, vlerësuar në total me 53.6 pikë.

Në vijim, KPP-ja, në zbatim të pikës 12 dhe 15, të kreut IV, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, me aktin administrativ të datës 30.12.2025, *“Për rezultatin përfundimtar të procedurës së pranimit në kategorinë ekzekutive në shërbimin civil për grupin e pozicioneve: #7260-lloji i diplomës “Shkenca Ekonomike/Shkenca Juridike”, niveli minimal i diplomës “Master Profesional”*”, ka vendosur përfundimin e fazës së vlerësimit, pa kandidatë fitues.

Në përfundim të analizës së fakteve të parashtruara më sipër, arrihet në konkluzionin se, procedura e konkurrimit me kod #7260, *“Shpallje për lëvizje paralele, pranim në shërbimin civil, në kategorinë ekzekutive”*, lloji i diplomës *“Shkenca Ekonomike/Shkenca Juridike”*, niveli minimal i diplomës *“Master Profesional”*, për 2 (dy) pozicionet: *“Specialist në Sektorin e Auditimit të Brendshëm për Skemat Kombëtare, në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm, në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, klasa e pagës IV-2”*, të shpallur nga DAP-i, është zhvilluar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe Vendimin nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*, i ndryshuar.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; të nenit 36, të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996, *“Kodi i Procedurës Civile”*, i ndryshuar, nenit 90, pika 2, e ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe nenit 16, pika 6, e

Rregullores “Për procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ dhe arkivimin e çështjes, të filluar në bazë të informacionit nr. 165 prot., datë 23.01.2026, të dërguar nga kandidati Majlind Shkira, me objekt verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera gjatë zhvillimit të procedurës së konkurrimit me kod #7260, për grupin e pozicioneve, “*Specialist në Sektorin e Auditimit të Brendshëm për Skemat Kombëtare, në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm*”, në institucionin Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, të shpallur nga DAP, duke qenë se, nuk konstatohen shkelje të ligjit në administrimin e shërbimit civil gjatë realizimit të kësaj procedure konkurrimi, si dhe në kushtet kur veprimet e Komitetit të Përhershëm të Pranimi vlerësohet se janë kryer në përputhje me ligjin.
2. Të njoftohet për këtë vendim institucioni i Departamentit të Administratës Publike dhe kandidati Majlind Shkira.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Lefterije Lleshi (Luzi)